



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural / Direkcija za Poljuprivredu i Ruralni Razvoj /
Department of Agriculture and Rural development

09. nr. 86/ 2024

Datë: 25.06.2024

**Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisionit vlerësues
për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve**

Bazuar në Thirrjen 09 Nr. 84 të datës 21.06.2024 të publikuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural / Komuna e Istogut për mbështetje financiare për projekte/ programe të OJQ-ve, me qëllim të *"Mbështetjes financiare për projektet e OJQ-ve për organizimin e aktivitetit tradicional, "Të Qethat 2024" dhe Dita e Mollës 2024"*, ftojme përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare/shoqërisë civile dhe ekspertët, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm.

Rregullorja MF-nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të organizatave joqeveritare, në nenin 8 paragrafi 3.2, përcakton që pjesë e secilit komision vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar në thirrjet publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, përfshirë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Për këtë qëllim, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural fton të gjithë kandidatët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm për të vlerësuar projekt propozimet e paraqitura nga OJQ-të përmes thirrjes publike.

- Një përfaqësues nga OJQ-të

- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Të drejtën për të aplikuar kanë:

- Punonjësit në organizata joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur me përvojë pune, ose fusha të ngjashme.

Aplikantët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Duhet të kenë të paktën nivelin e studimeve themelore universitare - Bachelor;
- Nuk duhet të jenë të emëruar politik,

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Letër motivimi;
- CV e azhurnuar;
- Provat e arsimimit dhe të përvojës së punës;

- Punonjësit e OJQ-ve duhet të paraqesin një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën është i angazhuar aplikanti.

I tërë dokumentacioni i nevojshëm duhet të dërgohet vetëm përmes adresës elektronike (e-mail; fadil.kabashi@rks-gov.net / Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural inkurajon fuqimisht anëtarët e komuniteteve jo-shumicë që të aplikojnë në këtë thirrje.

Ekspertet e jashtëm të përzgjedhur do të paguhen për angazhimin në procesin e vlerësimit

Për informacion shtesë mund të njoftoheni me telefon: 038 200 43 893

Vetëm kandidatët nga lista e shkurtër do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur 15 ditë pune nga data e publikimit, nga 25.06.2024 deri në 15.07.2024.

Aplikacionet që vijnë pas afatit dhe aplikacionet jo të plota do të refuzohen.

